

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6305
E martë, 4 maj 2021
çmimi 0.40 €

Mbi 53 mijë qytetarë
nga Kosova kaluan
fundjavën në Shqipëri

| FAQE 8




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



INTERVISTË ME PRESIDENTIN E "MABCO CONSTRUCTIONS",
PJESË E "MABTEX GROUP", EMIN PACOLLI | FAQE 4-5

ME SHQIPTARË KEMI NDËRTUAR VENDE DHE MBRETËRI TË HUAJA, TANI DO TA ZHVILLOJMË EDHE SHQIPËRİNË



"Mabco Constructions", pjesë e "Mabetex Group"-it, do ta ndërtojë Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës në të cilin projekt do të investohen mbi 100 milionë euro. Gazeta "Epoka e re" ka zhvilluar një intervistë me nënshkruesin e kësaj kontrate,

presidentin e "Mabco Constructions", pjesë e "Mabetex Group"-it, Emin Pacolli, i cili ka theksuar se ky është një ndër projektet më të mëdha të kompanisë së tyre në trojet shqiptare. Ai ka thënë se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të jetë qendër e gravitacionit të turizmit në Shqipëri

në aspektin e dizajnit, funksionalizimit dhe teknologjisë. Sipas Pacollit, ky aeroport do të ofrojë shërbime më efikase dhe më strategjike. Ai ka thënë se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të jetë qendër e gravitacionit të turizmit në Shqipëri

KËRKOHET
AMBIENT
I SIGURT PËR
GAZETARËT



| FAQE 3

HETIMI I
KRIMEVE TË
LUFTËS ME
KATËR
PROKURORË



| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

| FAQE 8

NUK KA KREDI PËR PUNONJËSIT
E SEKTORIT PRIVAT | F. 8

VENDET E BALLKANIT
NGA KORRIKU PA TARIFA PËR
ROAMING | F. 9

SPORT
PESË VJET NGA ANËTARËSIMI
I KOSOVËS NË UEFA | F. 12

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
088 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania deklarohet kundër çdo ndryshimi të kufijve në Ballkan

BERLIN, 3 MAJ - Gjermania kundërshton çdo ide apo propozim për ndryshim të kufijve në rajon, ka deklaruar të hënën në Berlin ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Heiko Maas, pas një takimi që ka pasur me ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani. "Ky është një dokument non-paper, jo një dokument zyrtar. Ne nuk kemi nevojë të merremi më tej me të. Nuk ka pjesëmarrje të Gjermanisë, në ndonjë non-paper, nëse ka zëra për këtë, ato janë lajme të rreme. Për politikën e jashtme gjermane, baza e politikës sonë për Ballkanin Perëndimor ka qenë gjithmonë që ne të mos ndërhyjmë në kufij", ka deklaruar Maas.

Shefi i diplomacisë gjermane ka thënë se çdo ndryshim i kufijve, kudo, do të ketë një ndikim në të gjithë rajonin dhe do të ketë

pasoja negative për të gjithë rajonin. "Këtë në të kaluarën e kemi refuzuar, edhe tani e hedhim poshtë, edhe në të ardhmen do ta refuzojmë plotësisht", ka deklaruar Maas. Edhe Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka hedhur poshtë idetë për ndarje, duke i vlerësuar të rrezikshme ndërsa ka theksuar se integrimi evropian i rajonit nuk ka alternativë. "Maqedonia e Veriut i ka përbushur të gjitha kriteret, e ka përfshirë 45 për qind të legjislacionit evropian në atë vendas, 95 % e politikës sonë të jashtme është harmonizuar me politikën e përbashkët të sigurisë, i kemi përbushur kriteret ekonomike dhe politike të anëtarësimit. Prandaj nuk shohim arsyë pse Maqedonia e Veriut duhet të mbetet mbrapa në këtë proces", ka deklaruar Osmani.



Ministri i Jashtëm gjerman ka thënë se Berlini angazhohet që Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria të mos ndahen, por t'i fillojnë paralelisht negociatat për anëtarësim në BE. Gjatë javëve të fundit nga mediat në Ballkan janë

të jetë thënë se procesi i dezintegrimit të ish-Jugosllavisë nuk është finalizuar. Tjetri është publikuar nga gazeta "Koha ditore" në Prishtinë, për të cilin është thënë të jetë hartuar nga Gjermania dhe Franca, si iniciativë për rinisjen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe përmbylljen e këtij procesi me një marrëveshje përfundimtare.

Në këtë dokument thuhen se Kosova e Serbia duhet të pajtohen që të themelohet një i ashtuquajtur "distrikt autonom i Kosovës Veriore", me kompetencia vetëqeverisëse. Ai do t'i përfshinte komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

"Non-paper" është një term që përdoret në BE lidhur me pikat e diskutimeve që ndahen në mënyrë konfidenciale ndërmjet qeverive dhe institucioneve.

Franca hap shkollat dhe heq kufizimet në udhëtim brenda territorit

PARIS, 3 MAJ - Fëmijët francezë u janë kthyer klasave nëpër shkolla dhe ndalesa për udhëtim brenda shtetit është hequr, ndërkohë që autoritetet lehtësojnë masat e izolimit të tretë, të vëna me qëllim të luftimit të pandemisë.

Qytetarët tani mund të udhëtojnë më larg se 10 kilometra larg shtëpisë dhe mund të shkojnë kudo nëpër Francë. Ata, po ashtu, nuk do të kenë nevojë të mbajnë me vete arsyetim për udhëtim.

Izolimi i tretë, që ka nisur së zbatuari nga muaji mars, ka qenë më i lehtë sesa dy izolimet e para.

Megjithatë, ora policore do të

vazhdojë të zbatohet. Sipas planit qeveritar, faza e ardhshme e lehtësimit të masave do të nisë më 19 maj. Atëherë ora policore do të nisë në orën 21:00 për dallim nga 19:00 sa është tani, do të hapen ambientet e jashtme të restoranteve dhe spektatorët do të mund të kthehen në salla të sportit. Franca aktualisht është duke regjistruar rreth 25 000 raste të infektuarve në ditë, derisa numri i pacientëve në kujdes intensiv ka rënë në 5 600. Prej shpërthimit të pandemisë, autoritetet franceze kanë regjistruar 104 800 viktima me koronavirus.



Anulohet sërisht festivali i birrës, Oktoberfest



MUNIH, 3 MAJ - Festivali i birrës Oktoberfest nuk do të mbahet për të dytin vit me radhë për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Ky festival mbledh rreth 6 milionë vizitorë në Munih çdo vit.

Kryetari i Bavarisë, Markus Soeder, u ka thënë gazetarëve se është e nevojshme të anulohen ngjarje të mëdha si

Oktoberfesti, sepse kërkojnë investime të mëdha, por edhe për shkak se rreziku është tejet i madh, marrë parasysh pasigurinë me pandeminë, e cila nuk dihet nëse mund të përshkallëzohet deri atëherë. "Në hapësirat klasike për festë të birrës, masat si distanca fizike dhe vendosja e maskës nuk mund të respektohen", ka thënë Soeder.

Gjermania ka vaksinuar më shumë se 28 për qind të popullsisë deri më tanë. Ndërkohë që rritet shkalla e vaksinimit dhe bie numri i të infektuarve, janë rritur shpresat për heqje të masave kufizuese, të cilat janë duke u zbatuar nga muaji nëntor i vitit të kaluar. Këtë vit Oktoberfest ishte planifikuar të mbahej nga 18 shtatori deri më 3 tetor.

KOSOVA SHËNON DITËN BOTËRORE TË LIRISË SË SHTYPIT

Kërkohet ambient i sigurt për gazetarët

Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Medias, Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka kërkuar ambient të sigurt për gazetarët. Zyrtarët e AGK-së kanë treguar se në Kosovë është rritur numri i rasteve të raportimit për pengim në punë ndaj gazetarëve. Sipas tyre, gjatë vitit 2020 janë raportuar katër raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe 17 raste të kërcënameve. Në këtë ditë zyrtarët shtetërorë të Kosovës dhe ambasadorët e akredituar në Prishtinë iu kanë dalë në krah gazetarëve duke thënë se kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve janë sulme ndaj demokracisë.

EPOKA
ERE

Muhamet KOçi

PRISHTINË, 3 MAJ - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka kërkuar ambient të sigurt për gazetarët. Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Medias, përfaqësuesit e gazetarëve u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës që ta respektojnë fjalën e lirë dhe të krijojnë një ambient të sigurt, demokratik dhe të lirë për ushtrimin e profesionit të gazetarit.

Leonora Dalipi, anëtare e AGK-së, në një konferencë përmjet media ka treguar se në Kosovë është rritur numri i rasteve të raportimit për pengim në punë, ofendime dhe shantazhe. "Fatkeqësish, nga viti në vit shtohen atakimet në forma të ndryshme në drejtim të gazetarëve.

Censura, vetëcensura dhe varësia financiare e mediave vazhdojnë të ndikojnë në të bërit gazetari objektive", ka deklaruar Dalipi. Ajo është ankuar edhe për zvarritjen e proceseve gjyqësore ndaj gazetarëve. "Zvarritja e proceseve gjyqësore të sulmeve ndaj gazetarëve dhe dënimet simbolike, për të mos thënë qesharake, vazhdojnë të mbeten pengesa kryesore në ushtrimin e profesionit", ka deklaruar Dalipi. Sipas saj, dënimet që shqiptohen shpesh konsiderohen "inkurajuese" përtakuuar fjalën e lirë.

Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Medias kanë reaguar edhe ambasadorët e akredituar në Kosovë dhe përfaqësues institucionalë. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, përditën Botërore të Lirisë së Shtypit ka thënë se kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve janë sulme ndaj vetë demokracisë. "Një shtyp i gjallë, i lirë që

informon publikun, fuqizon zërat e ndryshëm dhe mban përgjegjës zyrtarët publikë, është përbërësi themelor në çdo demokraci të qëndrueshme. Gazetarët e meritojnë respektin dhe mbrojtjen tonë. Kërcënimet dhe sulmet ndaj tyre janë sulme ndaj vetë demokracisë", ka shkruar ambasadori Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter". Kurse ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Nicholas Abbott, ka thënë se Kosova duhet të jetë krenare përshtypin e saj. Abbotti ka theksuar se raporti i fundit i botuar nga "Reporterët pa kufij" ka vërejtur që Kosova bie tetë vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit pas viteve të ngjitet së vazhdueshme në renditje. "Liria për të raportuar pa frikë nga ngacmimi ose frikësimi, qoftë fizik ose online, është jetik për çdo demokraci. Një mjesid i hapur, në të cilin mbrohen liritë e shtypit, është jetik për llogaridhëni dhe për stabilitetin afatgjatë të Kosovës. Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë të punojë përshtypit lirinë e mediave në Kosovë dhe në të gjithë botën", ka thënë Abbotti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar mediat në vendin tonë me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit. Me këtë rast, Osmani ka thënë se e vërteta duhet të jetë kauzë e përherershme e të gjithëve. "Liria është atribut i gjendjes së natyrshme, siç duhet të jetë edhe liria e shtypit. Në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit dua ta shpreh konsideratën time për mediat profesionale e të guximshme. Dua t'i inkurajoj ta vazhdojnë përpjekjen e tyre përaportim të drejtë e të paanshëm ngaqë liria e shtypit është parakusht themelor përfunksionimin demokratik të shoqërisë, të një shoqërie ku



çdo ditë krijojmë hapësirë përtakë dëgjuar mendimin ndryshe dhe ku secili ndihet i lirë ta thotë atë që e mendon. Media/gazetarë të nderuar, urime dita juaj! Hulumtoni, siguron prova, nxirri konkluzione në bazë të tyre. E vërteta duhet të jetë kauzë e përherershme e të gjithëve", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i Aleancës për Ardhmerinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se kushdo që kërcënon dhe sulmon mbi median e lirë është i humbur. Ai

ka thënë se mbrojtja e gazetarëve është ndër parimet e panegociueshme të demokracisë. "Sot të gjithë jemi gazetarë! Mbrotja e gazetarëve dhe medias së lirë është ndër parimet e panegociueshme dhe është obligim institucional e shoqëror ta ruajmë dhe avancojmë këtë segment të lirisë sonë! Sot, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, por edhe çdo ditë tjetër, jemi në krah të tyre, në mbrojtje e respekt të fjalës së lirë. Kushdo që kërcënon, shantazhon, ushtron presion dhe sulmon

median e lirë, mbi demokracinë tonë, është i humbur, sepse ka përballë një front të madh të bashkuar", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Në raportin e prezantuar nga AGK-ja, gjatë vitit 2020 janë raportuar katër raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe 17 raste të kërcënameve, kurse në raportin e fundit të organizatës ndërkombëtare "Reporterët pa kufij", që u publikua më 20 prill dhe vlerësoi lirinë e shtypit, Kosova u radhit në vendin e 78-të, përkatësisht tetë pozita më keq se vitin paraprak.



Veseli në Kosovë, u lirua nga Haga për ta vizituar babanë në spital

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është liruar nga Haga dhe ndodhet në Kosovë.

Veseli është liruar përkohësisht përtakë vizituar babanë i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore. Nuk dihet ende

kohëzgjatja e lejes së qëndrimit të tij në Kosovë, por ai po ruhet nga forca policore të Kosovës dhe nga EULEX-i.

INTERVISTË ME PRESIDENTIN E "MABCO CONSTRUCTIONS", PJESË E "MABETEX GROUP", EMIN PACOLLI

Me shqiptarë kemi ndërtuar vende dhe mbretëri të huaja, tani do ta zhvillojmë edhe Shqipërinë

"Mabco Constructions", pjesë e "Mabetex Group"-it, do ta ndërtojë Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës, në të cilin projekt do të investohen mbi 100 milionë euro. Gazeta "Epoka e re" ka zhvilluar një intervistë me nënshkruesin e kësaj kontrate, presidentin e "Mabco Constructions", pjesë e "Mabetex Group"-it, Emin Pacolli, i cili ka theksuar se ky është një ndër projektet me të mëdha të kompanisë së tyre në trojet shqiptare. Ai ka thënë se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të bëhet aeroporti më i bukur në aspektin e dizajnit, funksionalizimit dhe teknologjisë. Sipas Pacollit, ky aeroport do të ofrojë shërbime më efikase dhe më strategjike. Ai ka thënë se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të jetë qendër e gravitacionit të turizmit në Shqipëri

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Në Tiranë, më 20 prill 2021, është nënshkruar marrëveshja nga kompania e njohur "Mabco" dhe Qeveria e Shqipërisë për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës. Në emër të kompanisë fituese "Mabco" kontratën e ka nënshkruar presidenti i saj, Emin Pacolli, vëllai i ish-presidentit të Kosovës, biznesmenit dhe pronarit të "Mabetex Group", Behgjet Pacolli, ndërsa në emër të Qeverisë së Shqipërisë kontratën e ka nënshkruar ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.

Kontrata ka një vlerë mbi 100 milionë euro dhe përfundimi i

punëve pritet të bëhet brenda afatit trevjeçar. Gazeta "Epoka e re" ka zhvilluar një intervistë me nënshkruesin e kësaj kontrate, presidentin e "Mabco Constructions", Emin Pacolli, i cili ka theksuar se ky është një ndër projektet më të mëdha të kompanisë së tyre në trojet shqiptare. Ai ka thënë se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të bëhet aeroporti më i bukur në aspektin e dizajnit, funksionalizimit dhe teknologjisë. Sipas Pacollit, ky aeroport do të ofrojë shërbime më efikase dhe më strategjike. Ai ka pohuar se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës do të jetë qendër e gravitacionit të turizmit në Shqipëri. Po ashtu, ai ka thënë se synojnë të lënë



gjurmë të cilat do të trashëgojen nga gjeneratat e ardhshme dhe t'i sjellin përfitimet e tyre si në aspektin e punësimit, zhvillimit, turizmit etj... për shumë kohë shtetit shqiptar. Emin Pacolli ka theksuar se është ndier i privilegjuar që ka pasur mundësinë të jetë

nënshkrues i kësaj kontrate historike e cila është ndër më të rëndësishmet për kompaninë e tyre. Ai është shumë mirënjohës ndaj kryeministrit Edi Rama dhe popullit shqiptar që i besuan kompanisë së tyre ndërtimin e Aeroportit të Vlorës.

ekonominë në përgjithësi. Gjithnjë me shqiptarë kemi zhvilluar vende të huaja, tani kemi kënaqësinë që shqiptarët ta zhvillojnë Shqipërinë. Andaj gjatë nënshkrimit të kontratës ndjenjat ishin më të mira dhe të veçanta të mundshme.

"Epoka e re": Z. Pacolli, ju në emër të "Mabcos", pjesë e "Mabetex Group"-it, keni nënshkruar marrëveshjen "Mabco" me konsorciumin - Qeveria e Shqipërisë për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës. Çfarë ndjenje ishte ta nënshkruani këtë kontratë të madhe me shtetin shqiptar, në Vlorën ku u ngrit flamuri kombëtar?

Emin Pacolli: Sigurisht, simbolika që përdorët ju është e saktë, sepse pikërisht para satisfaksionit biznesor qëndrojnë emocionet për mundësinë për të kontribuar në shtetin amë, në këtë rast duke hapur vende të punës, rritur sektorin e turizmit dhe

"Epoka e re": Cili është interes i shtetit shqiptar dhe i juaj si kompani i reth ndërtimit të këtij aeroporti?

Emin Pacolli: Interesi i të dyja





palëve është ndërtimi i aeroportit më të bukur në aspektin e dizajnit, më funksionali dhe teknologjik për t'i ofruar shërbimet më efikase, më strategjike për ta bërë këtë aeroport 'qendër të gravitacionit' të turizmit në Shqipëri. Synojmë të lëmë një gjurmë e cila do të trashëgohet nga gjeneratat e ardhshme dhe t'i sjellë përfitime si në aspektin e punësimit, zhvillimit, turizmit etj... për shumë kohë.

"Epoka e re": Në Vlorë do të punojnë vetëm punëtorët tuaj të "Mabetex"-it apo do të merrni edhe punëtorë nga Vlora e Shqipëria? Sa punëtorë do të punësohen në këtë projekt?

Emin Pacolli: Numri i punëtorëve do të jetë i

konsiderueshëm, ndërsa ne si kompani kemi pasur si synim që prioritet t'u jepim punëtorëve shqiptarë, gjë që ka ndodhur në projektet tona anembanë botës, andaj nuk shoh përsë të mos angazhohen shqiptarët, vendasit në projektin në Vlorë.

"Epoka e re": Për sa kohë do të jetë gati Aeroporti i Vlorës? A do ta respektoni kontratën kohore apo do t'ia dilni ashtu siç keni bërë edhe në vendet e tjera që ta përfundoni punën para afatit të caktuar?

Emin Pacolli: Qëllimi ynë kryesor është cilësia dhe assesi nuk e sakrifikojmë atë në përfitim të faktorit kohor. Deri më sot kemi pasur privilegjin dhe kënaqësinë të kemi një

ekip të jashtëzakonshëm që ka bërë që të garantohet cilësia superiore dhe jo vetëm që të respektohen por, siç pohuat, të kryhen para kohës. Andaj, në synojmë që brenda afatit të paraparë, tre vjet, ta përfundojmë projektin më cilësor në rajon pastaj, nëse paraqitet mundësia, ta përfundojmë para afatit, pse jo.

"Epoka e re": Z. Pacolli, a keni në plan ju si "Mabetex Group" të aplikoni në projekte të mëdha të shpallura nga qeveria shqiptare e që janë në interes kombëtar?

Emin Pacolli: Sigurisht, kudo që mendojmë dhe vlerësojmë se mund të jemi zgjidhja më e mirë nga ofertuesit, nuk ka arsyë të mos marrim pjesë.

Bie numri i të vdekurve dhe i të infektuarve nga Covid-19 në Kosovë

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 MAJ - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 052 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 101

raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan një rast (82 vjeç), Prizren një rast (63 vjeç), Suharekë një rast (59 vjeç), Vushtrri një rast (78 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 105 636 raste nga 541 762 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 2187 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 421 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 95 466 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7

983. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 33 raste, Gjilan 9 raste, Prizren 9 raste, Gjakovë 8 raste, Ferizaj 6 raste, Mitrovicë 6 raste, Fushë-Kosovë 5 raste, Obiliq 5 raste, Pejë 5 raste, Deçan 4 raste, Podujevë 4 raste, Lipjan 3 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik dhe Vushtrri. Sipas raportimeve të datës 3 maj, nga klinikat Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet e përgjithshme, në tërë Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës janë duke u trajtuar 545 pacientë



nga Sars Cov-2. "438 janë të konfirmuar me Sars-Cov-2 pozitivë, 33 pacientë janë në gjendje të rënduar

shëndetësore dhe 419 janë nën asistim të oksigjeno-terapisë", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.

Komuna e Lipjanit po vazhdon mirëmbajtjen e hapësirave publike

LIPJAN, 3 MAJ (ER) - Komuna e Lipjanit po vazhdon edhe këtë vit mirëmbajtjen e hapësirave publike. "Në kuadër të

projektit të mirëmbajtjes së hapësirave publike, Komuna e Lipjanit edhe gjatë këtij viti me përkushtim të vazhdueshëm

po punon për mirëmbajtjen e ambienteve publike", ka njoftuar Komuna e Lipjanit. Kjo komunë ka vazhduar edhe

pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të varrezave në të gjitha vendbanimet e Komunës së Lipjanit.



Kryetari i Skenderajt nderon dëshmorët Liman Koca, Naim Xani dhe Nasuf Goxhuli

Skenderaj, 3 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, veteranë, familjarë të dëshmorëve, drejtorë komunalë, asamblistë qytetarë, ka bërë

homazhe e nderime për dëshmorët, Liman Koca, Naim Xani dhe Nasuf Goxhuli, në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve, në nderim të veprës së tyre sublime. Para familjarëve të dëshmorëve si

Jashari ka vlerësuar lart kontributin e dëshmorëve në çlirim e vendit, duke bërë njëkohësisht thirrje që të jemi të bashkuar pasi, sipas tij, vetëm kështu mund ta jetësojmë amanetin e të parëve tanë.

Bashkatdhetari nga Suedia sjell një autoambulancë për QKMF-në e Vushtrrisë

VUSHTRRI, 3 MAJ (ER) - Bashkatdhetari Shaban Krasniqi i cili jeton në Suedi ka sjellë donacion një autoambulancë për nevoja të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Vushtrri.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se në këtë kohë pandemie globale, kur shëndeti i qytetarëve është në rrezik, solidariteti e besimi i diasporës sonë është inspirim i madh.



Ka filluar hapja dhe rregullimi i disa rrugëve në fshatin Burim të Malishevës

MALISHEVË, 3 MAJ (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, përkatësisht të rregullimit të infrastrukturës rrugore, në fshatin Burim të Komunës së Malishevës, ka filluar hapja dhe rregullimi i disa rrugëve në lagjet e këtij fshati. Punimet në këto rrugë i ka parë nga afér edhe nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ishte i shoqëruar edhe asamblisti Avdi Morina, që vjen nga ky fshat.

Nënkyetari Berisha është takuar edhe me banorët e

këtyre lagjeve të cilët i ka uruar për rregullimin e rrugëve. "Rregullimi i infrastrukturës vazhdon të mbetet një prej prioriteteve tona si qeveri komunale, pasi rregullimi i rrugëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Për këtë qëllim, edhe këtu kemi filluar me hapjen e këtyre rrugëve, ku po bëhet zgjerimi i tyre dhe së shpejti do të përgatiten për asfaltim", ka thënë Berisha. Rregullimi i rrëth një kilometri rrugë në lagjet e fshatit Burim mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



200 familje me gjendje të rëndë ekonomike në Kaçanik ndihmon me pako ushqimore

Kaçanik, 3 maj (ER) - Organizata "Islamic Relief" ka ndarë 200 pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë ekonomike

në Kaçanik. Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Diana Reka, ka falenderuar këtë organizatë si dhe Kryqin e Kuq, i cili që

nga fillimi i pandemisë po merret me shpërndarjen e pakove në bashkëpunim me zyrtarët komunalë. Që nga fillimi i pandemisë e

deri më tanë qytetarët e Kaçanikut janë ndihmuar me pako ushqimore nga donatorë e organizata të ndryshme.



Hetimi i kimeve të luftës me katër prokurorë



Prishtinë, 3 maj - Fetah Berisha nga fshati Burim, komuna e Vushtrrisë, ka të vrarë gjatë luftës babanë dhe xhaxhanë, ndërsa një vëlla të zhdukur. Berisha tregon për "Radion Evropa e Lirë" se që kur ka mbaruar lufta në vitin 1999, asnë zyrtar nga sistemi i drejtësisë nuk e ka pyetur atë apo ndonjë familjar tjetër për rastin e vrasjeve dhe zhdukjes së vëllait.

Berisha theksoi se ka dëshmi përvrasjet që kanë ndodhur por, siç shprehet ai, nuk ka shpresë se kryesit e kimeve do të mund të dalin para drejtësisë. "Në familjen tonë nuk ka marrë askush kurrfarë shënimesh dhe nuk di asgjë... sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Nuk jemi optimistë se do të ndriçohet diçka. Me këtë ritëm të punës dhe me këtë sistem të drejtësisë, nuk presim diçka. Nëse ndërron diçka, nëse rritet numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndoshta ndryshon diçka. Përndryshe, nuk e di, kështu jemi ne [në këtë gjendje] dhe shumë familje që kanë humbur familjarët e tyre gjatë luftës", ka thënë Berisha.

Që nga përfundimi i luftës e deri më tash, në Kosovë, në Serbi dhe në Hagë, janë dënuar më pak se 70 persona për kime luftë. Sipas të dhënave nga Fondi për të Drejtë Humanitare në Kosovë, që ka monitoruar proceset e gjykimeve në rastet e kimeve të luftës, thuhet se deri tanë, në Kosovë, për kime të luftës në procese gjyqësore, kanë qenë të përfshirë 111 persona, kurse janë dënuar vetëm 41 prej tyre.

Sipas organizatave joqeveritare që merren me këtë çështje, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT] dhe Fondi për të Drejtë Humanitare në Kosovë [FDHK], institucionet e Kosovës ende nuk janë duke e marrë seriozisht trajtimin e kimeve të luftës, sepse mungojnë prokurorët për këtë çështje.

Këshilli Prokurorial i Kosovës thotë se aktualisht në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës janë vetëm katër prokurorë, të cilët janë duke punuar në trajtimin dhe hetimin e rasteve të kimeve të luftës. Në kuadër të

Prokurorisë Speciale është departamenti i veçantë i cili merret me krimet e luftës. Ata kanë shtuar se ky këshill ka bërë shpalljen e brendshme përvacanimin edhe të dy prokurorëve në këtë prokurori.

Më shumë se 13 500 persona u vranë gjatë luftës më 1998-'99

Nga ana tjetër, Feride Rushiti, drejtoreshë ekzekutive në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), thotë se përsëshqitjen e kimeve të luftës duhet të ketë numër më të madh dhe angazhim më të fuqishëm të prokurorëve. "Ky numër kaq i vogël i prokurorëve vë në pah se sa me seriozitet janë trajtuar krimet e luftës dhe ky numër kaq i kufizuar i prokurorëve, vë në pah pastaj edhe moszbardhjen e kimeve të luftës dhe mosndëshkimin e gjithë atyre kimeve", ka pohuar Rushiti. Sipas të dhënave të Fondit për të Drejtë Humanitare, gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999

janë vrarë më shumë se 13 500 njerëz, shumica dërrmuese e të cilëve ishin civilë shqiptarë. Muaji më i përgjakshëm ishte prilli i vitit 1999 kur u vranë 4 082 persona.

Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtë Humanitare thotë përvakueshme se pse në Departamentin për Kime Luftë në Prokurorinë Speciale aq pak prokurorë merren me krimet e luftës. "Por, ne nuk besojmë se mjafton vetëm rritja e numrit të prokurorëve, sigurisht se ata duhet të përkrahen edhe me staf tjetër. Vetë fakti apo informatat që vijnë nga kjo prokurori, tregojnë se është e domosdoshme që të rritet numri, sepse ata kanë trashëguar shumë lëndë nga EULEX-i", ka deklaruar Blakaj.

Në Serbi, për krimet e luftës në Kosovë, janë dënuar 17 persona me vendim të formës së prerë, ku dy nga ta kanë qenë shqiptarë. Ndërsa në Gjykatën Ndërkombëtare për Kime Luftë në ish-Jugosllavi, me seli në Hagë të Holandës, janë dënuar tetë persona, nga ta dy shqiptarë, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës. Këshilltarja e përhershme ligjore në Departamentin Amerikan të Drejtësisë, Lana Morton-Owens, në një intervistë përmisionin përvakueshme të ligjit 'Iustitia', thotë se Kosova ka trashëguar rreth 1 000 raste të kimeve të luftës nga UNMIK-u dhe EULEX-i. "Këta prokurorë janë vendosur në një pozitë jo të drejtë, sepse ata kanë trashëguar gjithë këto raste dhe ato janë rreth 15 vjet të vjetra. Unë mendoj se ka pasur pak përmirësim dhe duhet të ketë edhe më shumë. Ne dëgjojmë shumë biseda nga politikanë të ndryshëm, se si do të krijojnë institucione të reja dhe duan të bëjnë shumë gjëra kur flitet përvakueshme. Në Kosovë, janë dënuar 17 persona me vendim të formës së prerë, ku dy nga ta kanë qenë shqiptarë". Morton-Owens.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në një përgjigje përvakueshme, ka thënë se në planet e punës dhe politikat e veta, në vazhdimësi e ka fuqizimin e prokurorive me kapacitete të reja njerëzore.

Arbër Grabovci tërhiqet nga kandidatura për kryetar të Pejës

Pejë, 3 maj (ER) - Arbër Grabovci, i cili më herët ka shpallur kandidaturën përkryetar të Pejës nga radhët e AAK-së përzgjedhjet lokale, ka bërë me dije se nuk do t'i hyjë

kësaj gare përkryetar të komunës. Ai është tërhequr edhe nga posti i kryetarit të Degës së AAK-së në Pejë. "Për shkak të disa çështjeve personale dhe në konsultim me

kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinaj, nga sot tërhiqet nga posti i kryetarit të degës dhe kandidatit përkryetar të Komunës së Pejës. Angazhimet e mia do t'i vazhdojnë në kuadër

të grupit të asamblistëve të AAK-së në Kuvendin Komunal të Pejës dhe do t'i jem prore pjesë e Aleancës!", ka shkruar Grabovci në llogarinë e vet në "Facebook".



Nuk ka kredi për punonjësit e sektorit privat

PRISHTINË, 3 MAJ - Aprovimi i një kredie në bankat komerciale, për punonjësit e sektorit privat, është proces i vështirë, e në disa raste i pamundshëm, thotë Ardita, e cila ka aplikuar për një vlerë të kredisë në dy institucionë financiare në Kosovë, dhe që në të dyja ia kanë refuzuar kërkesën.

Arsyeja e refuzimit të kërkesës, sipas saj, ka qenë afati kohor i kontratës që ka me kompaninë ku ajo punon. Ardita, 25-vjeçare nga qyteti i Vushtrrisë, që tre vjet punon në një qendër tregtare, me pagë mëjore 300 euro, kurse kontrata e saj vazhdohet për çdo vit. "Nuk kam marrë përgjigje pozitive. Më kanë thënë se kontrata nuk është e sigurt. (Bankat) po kérkojnë një bashkëhuamarrës që punon në institucionet publike, me kontratë afatgjatë. Shumën që unë po e kérkoj, asnjëra bankë nuk po e aprovon, vetëm sepse punoj në sektorin privat", ka thënë Ardita.

Por, Labinoti që punon që shtatë vjet në institucionë publike, para gjashtë muajsh ka marrë kreditin e dytë në një nga bankat private që operojnë në Kosovë. Ai thotë se nuk ka pasur asnjë kërkesë për dokumente shtesë apo garantues.

Krejt çka i ka kérkuar banka, siç tha ai, ka qenë kontrata e punës. "Më është kérkuar kontrata e punës, e cila është pa afat të caktuar. Nuk kam pasur ndonjë problem. Edhe pse vlera e kredisë së parë nuk është e vogël, edhe kredia e dytë më është aprovuar brenda ditës, pa bashkëhuamarrës apo garantues", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

"Rel" e ka pyetur Shoqatën e Bankave të Kosovës për këtë çështje, por deri në momentin e publikimit të tekstit, nuk kanë kthyer ndonjë përgjigje.



Banka Qendrore e Kosovës, ndërkaq nuk evidenton ndaras kredimarrësit e sektorit privat dhe ata në sektorin publik.

Bektashi: Paga minimale ndikon në procesin e kreditimit

Institucionet bankare jo rrallëherë në uebfaqet e tyre publikojnë ofertë për kredi për punonjësit e sektorit publik. Ky sektor numëron rreth 80 mijë të punësuar, por sektori privat llogaritet punëdhënësi më i madh, me mbi 220 mijë punëtorë. Paga mëjore në këtë sektor është më e vogël, nën 350 euro, krahasuar me pagën mesatare në sektorin publik, e cila arrin në mbi 500 euro.

Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se punonjësit e sektorit privat

janë të diskriminuar në procesin e sigurimit të mjeteve kreditore. Një nga arsyet e qasjes në kredi, sipas tij, është vlera e pagës minimale në Kosovë, që është 170 euro. "Shumë punëdhënës në sektorin privat, për t'u ikur taksave, paguajnë vetëm vlerën e pagës minimale, kurse pjesën tjetër e paguajnë me para të gatshme. Faktikisht, kjo është një pengesë për të punësuarit për të pasur qasje në kredimarrje. Ngritja e pagës minimale në 250 ose 300 euro duhet të ndodhë gjithsesi brenda këtij viti kalendarik", ka thënë ai.

Paga minimale në Kosovë që nga viti 2011 ka mbetur e pandryshuar. Paga minimale është 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç, dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç. Lëvizja Vetëvendosje, e cila tani është në pushtet, në programin e saj kishte planifikuar që pagën

minimale ta rrisë në 250 euro dhe kjo pagë të përjashtohet nga tatimi në të ardhurat personale.

Kthimi i kredisë nga punonjësit e sektorit publik është më i sigurt

Përveç pagës minimale, arsyet tjetër Bektashi përmend edhe rritjen e pagave në sektorin publik për dallim nga sektori privat, që nuk vërehet ndonjë lëvizje sa iu përket të ardhurave mëjore. "Arsyet mund të jenë të ndryshme. E para ka të bëjë me periudhën e krisës, që në Kosovë nuk është vetëm periudha e pandemisë, por edhe një periudhë para vittit 2019, ku niveli i pagave në sektorin privat ka mbetur rreth 30 për qind më i ulët se në nivelin e sektorit publik apo 40 për qind në nivelin e ndërmarrjeve publike. Bankat, duke e vlerësuar riskun e kthimit të kredive,

kanë një siguri më të madhe në sektorin publik", ka thënë ai.

Edhe Ardita thotë se më me dëshirë do të gjente një vend pune në sektorin publik edhe me pagë më të vogël sa merr aktualisht. Ajo ka të përfunduar Fakultetin Juridik, në një nga kolegjet private dhe është në kërkim të një vendi pune në institucionet publike, pikërisht për shkak të zbatimit të kontratës dhe afatit kohor të saj. "Për shkak të kontratës së punës pa afat të caktuar kohor, pushimet, festat... Kurse në sektorin privat asgjë nuk ka të sigurt, as kredi më nuk të jepin", ka theksuar ajo. Ndryshe, vlera e kredive në dhjetë bankat komerciale që veprojnë në Kosovë ka arritur në mbi 3.2 miliardë euro. Nga kjo shumë, 1.1 miliard janë kredi familjare, kurse mbi 2 miliardë kredi për biznese. Vetëm për tre muajit e parë të këtij viti, janë aprovuar kredi në vlerë 405 milionë euro, me normë mesatare 6.2 për qind.

Vendet e Ballkanit nga korriku pa tarifa për roaming

PRISHTINË, 3 MAJ - Nga data 1 korrik 2021 qytetarët e Kosovës gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të paguajnë asnjë shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut në kuadër të telekomunikimit siç janë thirrjet e realizuara ose të pranuara dhe mesazhet, thuhet në një përgjigje të Autoritetit Rregullativ të

Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP), raporton "Rel". Kjo do të ndodhë në bazë të një marrëveshjeje për roaming në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Kosovës dhe Serbisë).

Faza e parë e zbatimit të marrëveshjes ka filluar në

vitin 2019, ku ka pasur një ulje të çmimeve deri në 80 për qind, kurse faza e dytë, apo eliminimi i tërësishëm i tarifave, është paralajmëruar se do të zbatohet më 1 korrik 2021.

Tarifa e roamingut nënkupton telekomunikimin dhe shërbimin që qytetarët e përdorin në një shtet tjetër, nga një qendër e operatorit të telefonisë mobile.



Shqiptarët shpenzuan 566 milionë euro për blerjen e pronave jashtë vendit



Prishtinë, 3 maj - Shpenzimet e shqiptarëve për prona jashtë vendit po rriten me shpejtësi viti pas viti duke treguar se një pjesë e fitimeve dhe kursimeve që gjenerohen brenda vendit transferohen jashtë vendit duke blerë kryesish banesa. Në seksionin e llogarive kombëtare për Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), "Instat" raportoi se në vitin 2019 shpenzimet e shqiptarëve që janë rezidentë në Shqipëri për prona jashtë vendit arritën 566 milionë euro.

Blerjet e pronave jashtë vendit shënuan një nivel rekord në vitin 2019 me një rritje vjetore mbi 44 për qind. Shpenzimet për prona jashtë vendit erdhën në rritje të vazhdueshme sidomos pas vitit 2011. Ato ishin të ulëta deri në vitin 2007, por pas krizës së vitit 2008 u pa një rritje jo e zakonte e tyre. Nga 7 miliardë lekë shpenzime për prona jashtë vendit në vitin 2007, një vit më pas, më 2008 kjo vlerë u rrit më shumë se katërfish, në 32 miliardë

lekë. Përgjatë periudhës 2008-2013, shpenzimet e shqiptarëve rezidentë në Shqipëri për prona jashtë vendit ishin 1,6 miliard lekë euro. Në vitin 2013 pati një rënie të treguesit, ku shihet të janë shpenzuar vetëm 11 miliardë lekë ose tri herë më pak se më 2012. Blerjet e pronave jashtë vendit nisen sërisht me ritme të shpejta pas vitit 2014. Sipas të dhënave të "Instat"-it, nga viti 2014 në vitin 2019 shpenzimet e shqiptarëve për prona jashtë

vendit arritën në 2 miliardë euro. Rekordin e mban viti 2019, ku vlera e treguesit arriti në 431 milionë euro. Nga viti 1996 deri në vitin 2019 shpenzimet për prona jashtë vendit arritën në 497 miliardë lekë ose rreth 4 miliardë euro. Në mungesë të instrumenteve financiare, shqiptarët gjithnjë e më shumë po i shohin pasuritë e paluajtshme sidomos banesat si një mjet investimi. Kjo tendencë po shihet nga një vrull i madh i

ndërtimeve brenda vendit. Ndërtimet e reja, sidomos në Tiranë, janë luksozë dhe kanë si target blerës me të ardhura shumë të larta. Këto të ardhura që përdoren për blerjen e pronave shpesh nuk justifikohen nga burimet zyrtare. Sektori i ndërtimit ishte një nga tipologjitet kryesore për pastrimin e parave nga organizatat e krimit të organizuar për vitin 2020, raportoi Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

Mbi 53 mijë qytetarë nga Kosova kaluan fundjavën në Shqipëri

Prishtinë, 3 maj - Për Ditën Ndërkombëtare të Punës, që njihet si festa e 1 majit, 53 mijë punëtorë nga Kosova po e shfrytëzojnë pushimin në Shqipëri. Festa zyrtare e 1 majit që ishte të shtunën dhe festa tjetër Pashkët Ortodokse të dielën, për këto dy festa zyrtare në fundjavë, institucionet e shtetit do të pushojnë të hënën dhe të martën. Gjatë fundjavës, sipas Policisë së Kosovës, vetëm në pikat kufitare me



Shqipërinë kanë kaluar 53 588 prill, kanë kaluar kufirin 17 939, të shtunën më 1 maj 23

516 dhe më 2 maj të dielën 12 133 qytetarë", thuhet në një përgjigji me shkrim për "KosovaPress" nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun në Policinë e Kosovës. Qeveria e kaluar me kryeministrin Avdullah Hoti kishte miratuar Projektligjin, që në ditët e festave zyrtare kur i bie e shtunë ose e diel, nuk do të pushohet më të hënën. Ky Projektligj ka mbetur në sirtarët e Kuvendit të Kosovës.

Për festën e 1 majit në çdo vend të botës organizohen protesta për të drejtat e punëtorëve, në Kosovë nuk pati protestë të organizuar nga BSPK-ja për shkak të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes Covid-19, mirëpo u organizuan nga disa sindikata të tjera. Si pasojë e pandemisë, të premten janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv, të shtunën 5, dhe të dielën 5.

CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (7)

Fizika simetrike e Naim Krasniqit, unifikim i fizikës së makrobotës dhe mikrobotës



Nga: Naim KRASNIQI,
fizikan

Lidhshmëria në mes përkuljes së hapësirës dhe elasticitetit të sajë

Vetë fjalë përkulje e kohë-hapësirës të jep për të kuptuar se kohë-hapësira janë elastike, prandaj në çfarëdo eksperimenti që do ta bëjmë me pëlhura elastike apo njëte elastike, sipërfacja më e ulët elastike ku bie sfera e magnetizuar ushtron presion mbi të gjitha fijet apo rrëth tërë sipërfaqes së saj, duke i shtrënguar dhe duke ia zvogëluar elasticitetin e të gjitha pjesëve përtëj qendre. Në këtë mënyrë edhe te vendet ku lëshohen sferat e vogla në pëlhurën elastike, nuk e kanë elasticitetin e njëjtë sikur në rastin e parë kur nuk ishte lëshuar sfera e magnetizuar, sepse ky elasticitet tani ka humbur në të gjitha anët e pëlhurës dhe është konsumuar nga sfera e magnetizuar.

Rrotullimi i planetit të Plutonit rrëth Diellit

Deformimin e kohë-hapësirës të relativitetit gjeneral i Albert Ajnshtajn (Albert Eisteinit) e bën të pamundshëm edhe planeti i Plutonit. Tani shtrohet pyetja pse hapësira e orbitës së planetit të Plutonit nuk lakohet njëjtë, e cila do t'i mundëson këtij planeti të lëvizte në një plan elliptikë me trupat e tjerë qiellorë që rrotullohen rrëth Diellit. Apo planeti i Plutonit ka një masë të dyfishtë gjatë lëvizjes së tij rrëth Diellit, çka do të thotë se planeti i Plutonit ka një masë më të lehtë në gjysmën e orbitës kur ndodhet mbi planin elliptikë gjatë rrotullimit rrëth Diellit, kurse ka masën më të rendë se sa Dielli e ka kur e lakon kohë-hapësirën më shumë se Dielli, si dhe kur ndodhet në gjysmën tjetër të orbitës së tij që ndodhet në anën e poshtme të planit elliptik nëpër të cilën lëvizin planetët rrëth Diellit.

Fizika simetrike e Naim Krasniqit, unifikim i fizikës së makrobotës dhe mikrobotës:

Fizika simetrike e themeluar nga

unë Naim Krasniqi nuk ka asnë lidhshmëri me forcën gravitacionale të Isak Njuton (Isaac Newtonit) as me deformimin e kohë hapësirës së Albert Ajnshtajnit. Duke mos hyrë në thëllësi këtu do t'i sqarojmë ligjet kryesore të fizikës simetrike që janë botuar gjatë këtyre viteve, të cilat ligje e bashkujnë fizikën e mikrobotës me fizikën e makrobotës. Një përbledhje e ligjeve që janë publikuar gjatë këtyre viteve.

Ligji i fundamental i forcës tërheqëse në fizikën simetrike të makrobotës

Forcat tërheqëse në makrobotë te trupat qiellorë i shkaktojnë fenomenet natyrore të cikloneve që formohen gjatë reaksioneve natyrale në mes grimcave ($aX + aY$).

Ligji i fundamental i forcës tërheqëse në fizikën simetrike të mikrobotës

Forcat tërheqëse në fizikën e mikrobotës në mes grimcave në brendësi të bërrhamës së atomit i shkaktojnë fenomenet natyrore të cikloneve që formohen gjatë reaksioneve natyrale në mes grimcave ($aX + aY$).

Ligji i fundamental i fushës magnetike në fizikën simetrike të makrobotës

Fushët magnetike në fizikën simetrike të makrobotës te trupat qiellorë e krijojnë fenomenet e tornadove elektromagnetike që krijojnë gjatë reaksioneve natyrale në mes grimcave ($aX+aZ$).

Ligji i fundamental i fushës elektrostatike në fizikën simetrike të mikrobotës

Fushët elektrostatike në fizikën e mikrobotës te grimcat në brendësi të bërrhamës së atomit e krijojnë fenomenet e tornadove elektromagnetike që krijojnë gjatë reaksioneve natyrale në mes grimcave ($aX+aZ$).

Energjinë e zezë në fizikën e makrobotës dhe fizikën e mikrobotës e ka zbuluar paaftësia e komunitetit shkencorë

Fizicentët e energjisë së lartë apo energjisë bërrhamore në fillim të

vitit 1970 kishin marrë iniciativë për ta themeluar modelin standard të fizikës së grimcave, por befasia më e madhe është se për çfarë arsyen kanë anashkaluar apo pse i kanë myllur sytë mbi prezencën e (energisë së zezë), apo një lloj energjie që ekziston në brendësi të bërrhamës së atomit. Asnjëra nga forcat e forta, të dobëta as elektromagnetike nuk funksionojnë ashtu sikurse e sqaron modeli standard i fizikës së grimcave.

Ligji i fundamental i fushës antimagnetike në fizikën simetrike të makrobotës

Prandaj nuk ekzistojnë asnjë energji e zezë në fizikën simetrike të makrobotës.

Fusha antimagnetike që buron nga trupat qiellorë, të cilët posedojnë fusha magnetike vetanake si dhe rrëth të cilëve rrotullohen trupa të tjerë qiellorë e formojnë fushën antimagnetike si një forcë e vetme repulsive që u kundërvihet forcave tërheqëse të cikloneve të trupave qiellorë.

Ligji i fundamental i fushës antielektrostatike në fizikën simetrike të mikrobotës

Ngjashëm sikurse nuk ekziston energjia e zezë në fizikën e makrobotës. Ajo nuk ekziston edhe në fizikën e mikrobotës. Fusha antielektrostatike që ka burimin nga fusha elektrostatike e ngarkesave elektrike, është e vetmja forcë reale repulsive që u kundërvihet forcave tërheqëse të cikloneve dhe ngarkesave të grimcave në brendësi të atomit.

Ligji i fundamental i distancës në mes trupave qiellorë në fizikën simetrike të makrobotës

Distanca e në mes trupave qiellorë është një faktor që varet vetëm nga fusha antimagnetike që buron nga trupat qiellorë rrëth të cilëve rrotullohen trupa të tjerë qiellorë. Niveli i fushës antimagnetike varet nga intensiteti i fushës magnetike që buron nga tornadova elektromagnetike e një trupi qiellorë si dhe nga sasia e materialit feromagnetik që ndodhet mbi polet e magnetit përkatësisht të tornados elektromagnetike.

Ligji fundamental i distancës në mes grimcave në bërrhamën e atomit në fizikën simetrike të mikrobotës

Distanca e në mes të grimcave elektrike në brendësi të bërrhamës së atomit varet vetëm nga fusha antielektrostatike që buron nga fusha elektrostatike e këtyre grimcave. Niveli i fushës antielektrostatike varet nga intensiteti i fushës elektrostatike që buron nga tornadova elektromagnetike e grimcave elektrike, si dhe nga sasia e kuarkeve pozitive apo negative që ndodhet mbi polet e tornados elektromagnetike.

Ligji fundamental i ekspansionit të universit në fizikën simetrike të makrobotës

Fusha antimagnetike që buron nga të gjithë trupat qiellorë rrëth të cilëve rrotullohen trupa të tjerë qiellorë, që mbajnë shpejtësi këndore konstante të rrotullimit apo kanë rritje të sajë, ndikon në uljen e niveleve të fushave magnetike në polet magnetike të këtyre trupave qiellorë, e cila ulje shkakton rritjen e fushave antimagnetike të trupave qiellorë, nga më të veglit e deri më të mëdhenjtë e shkaktojnë ekspansionin e Universit.

Përbledhje

Siq po shihet këto janë vetëm disa sqarime që lexuesit i kanë pasur në dorë dhe kanë mundur t'i lexojnë përgjatë këtyre viteve. Është fakt që nuk mund të mohohet se përpas lexuesve nga trojet shqiptare këto shënimë përmes individëve, institucioneve dhe portaleve të ndryshme shumë lehtë kanë kaluar te hulumtues të ndryshëm shkencorë, filozofë shkencash, në institucionet e tjera kërkimore shkencore dhe ndërkombëtare, duke e përfshirë edhe CERN, FERMILAB, NASA, ESA, CNES... e shumë e shumë të tjera anekënd botës. Ngjashëm sikur informacionet e vendeve të tjera që përkthehen nga të gjitha gjuhët e lexohen dhe transmetohen nga portalet në gjuhën shqipe. Këto institucione shkencore që janë duke punuar në gjetjen e grimcave që formojnë energjinë e zezë apo që e

shkaktojnë ekspansionin e universit, pa përashtime asnjëherë nuk ndodh ta pranojnë një realitet të tillë, e që janë bazuar në publikimet e mia në gazeten "Epoka e re" (në versionin e shtypur dhe atë online), sepse këto shënimë mund t'i mbajnë nën tavolinat e tyre, të përkthyerë në gjuhët e tyre nga të cilat mundohen të gjejnë mënyra të ndryshme për devijime anësore për t'ju shëmangur fushës antimagnetike në makrobotë dhe fushën antielektrostatike në mikrobotë, si dhe fenomene të cikloneve tornadove elektromagnetike, rigjenerimit dhe fushës simetrike të magnetit. Ndërsa që vonë tentojnë të dalin jo gjetëm këtë grimcë jo atë grimcë, por asgjë nuk do të gjejnë pos fushës antimagnetike si një forcë repulsive në makrobotë dhe fushës antielektrostatike si forcë repulsive në mikrobotë apo elementeve (aX, aY, aZ dhe a), si dhe rigjenerimeve të ndryshme. Deponimi i fushës antimagnetike dhe antielektrostatike në INPI të Francës Fusha antimagnetike dhe fusha antielektrostatike si forca repulsive në makrobotë dhe mikrobotë janë deponuar në INPI - Institut national de la propriété industrielle në Francë me numër 499908 të datës 05/02/2014 si dhe me numër 572840 të datës 07/09/2016 dhe është publikuar për herë të parë në vitin 2016. Është e njojur në arenën ndërkombëtare shkencore se njerëzit injorohen përsë gjalli, jo që nuk e kuptojnë zbulimet e ndryshme nga njerëz të ndryshëm, por për shkak të interesave të ndryshme politike, personale dhe mbrojtjen e karrigeve në institucionet e ndryshme shkencore. Prandaj a është lehtë të gjendet dhe të vërtetohet fusha antimagnetike, kur tani nuk të duhen hiq më shumë se 50 euro shpenzim, qoftë CERN apo FERMILAB dhe ç'do institucion tjetër shkencor mund ta gjejë dhe ta vërtetojë të gjithë këtë fushë antimagnetike, e mos të flasim për qendra hulumtuese shkencore. Ashtu sikur kam deklaruar më parë në gazeten "Epoka e re" në vitin 2019, prapë qëndroj pas atyre deklarimeve se këto që janë dhënë më lartë do mbesin një kushtetutë shkencore të cilat nuk mund t'i anashkalojë askush, pa marrë parasysh emërtimet e ndryshme që tentojnë t'i bëjnë. Sa më parë që pranohen aq më shpejtë avancohet fizika simetrike, një udhëtim drejt universit. (Fund)

JAMES W. PARDEW KONTRIBUESI DHE PËRKRAHËSI MË I MADH DHE NË VAZHDIMËSI I MARRËVESHJËS SË OHRIT



Ismet Sylejmani

Marrëveshja e Ohrit është njëra ndër tri marrëveshet e mëdha paqësore përfundime luftërash, nga katër luftëra me gjakëderdhje të mëdha, gjithesej sa ishin zhvilluar në truallin e larë me gjak të ish-Jugosllavë!

Marrëveshja e Dejtonit, Marrëveshja e Rambujesë dhe Marrëveshja e Ohrit, janë këto tri marrëveshet e mirënjojura, fati i të cilave është ndryshe e ndryshe nga njëra tjetra!

Ish-Jugosllavia u prish e u shkërrua tërësisht!

Marrëveshet paqësore që u arritën, me ndërmjetësim ndërkombëtar, në debaklin total të ish-Jugosllavisë, të kësaj krijese artificiale e cila doli se ishte eksperiment i rrezikshëm dhe shkatërrues për njerëzimin, nuk arritën, me përshtim të asaj të Ohrit, të ishin të tilla që të ndalnin luftën, të menjanoin gjakderdhjen e gjenocidin dhe të evitonin tragedji botërore!

Egzistencia e ish-Jugosllavisë padishim se ishte e veshtrirë, ndonëse koha e dëshmoi, se kjo krijë artificiale ishte e destinuar të prodhonte vetem konflikte e vetem luftëra, vetëm derdhje gjaku, vetëm gjenocid e terror permanent mbi popujt e sajë e veçanerisht mbi popullin shqiptar të Kosovës dhe Viseve të sajë!

Marrëveshja e Dejtonit u arrit por dështoi!

Marrëveshja e Rambujesë u arrit, nuk dështoi, por u mbulua me derdhje gjaku, me gjenocid, me

deportim masiv e zhvendosje njerëzore, me dhunë e me terror mbi popullin shqiptar të Kosovës! Marrëveshja e Ohrit edhe u arrit edhe u rrespektua!

Arritjen e Marrëveshjes së Ohrit e bëri të mundur lufta heroike dhe titanike fitimtare e UÇK-së, e drejtuar, e udhihequr dhe e komanduar me largëpamësi nga themeluesi i sajë dhe Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm, Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti!

Arritjen e Marrëveshjes së Ohrit e bëri të mundur përfaqësuesi special i Washingtonit, Ambasadori Amerikan James W. Pardew, por edhe ndihmës të tjerë si përfaqësuesi i NATO-s Peter Feith dhe përfaqësuesi i BE-së Fransoa Leotar!

Marrëveshja e Ohrit, ishte e fundit që u arrit në truallin e republikave dhe krahinave të ish-Jugosllavisë, pra ishte e treta, por edhe e verteta, sepse ishte më e sakta, më koncizja dhe përfundimisht më e zbatuara!

Në këtë Marrëveshje paqësore e historike, rolin kryesorë dhe dominant nga ndërkombëtaret e ka pasur SHBA e përfaqësuar nga diplomati i saj i posaçëm, Ambasadori James W. Pardew!

Ambasadori James W. Pardew u bë i njohur dhe i famshëm në Ballkan kur u emërua përfaqësues i SHBA-ve në IRJ të Maqedonisë, u bë edhe më i famshëm kur u arrit Marrëveshja e Ohrit, përpos i famshëm, u bë edhe shumë i dashur për shqiptarët kur shkoi të drekonte me kontigjentin e parë të policëve shqiptar, atëherë kur e hodhi për toke tabakanë e ushqimit, duke dekluaruar se ky ushqim nuk është në nivel për policët e rinjë, për ata që në të ardhmen do ta përfaqësojnë dhe mbrojnë shtetin dhe do ta zbatojnë rendin ligjorë!

Marrëveshja historike e Ohrit, jo



JAMES W. PARDEW

vetëm ishte me e sukseshmja dhe më e zbatueshmja, por ishte edhe më e famshëm, sepse përmbyllte përfundimisht luftërat në ish-

Jugosllavi!

Konfirmonte se Jugosllavia u shemb e u shkatërrua përfundimisht me luftën e popullit shqiptar ne Maqedoni për të drejta e për barazi nationale!

Marrëveshja e Ohrit, te Ambasadori amerikan James W. Pardew, e kishte njërin prej kotribuesve dhe përkrahësve më të mëdhenj të saj, por këtë rol të tij të madh e ka pasur në vazhdimësi, pasqyrë e tregues real kjo e aleatit tonë të madh SHBA, e cila që nga fillimi i luftës së UÇK-së në Kosovë kundër Serbisë pushtuese, e në luftën e UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, kurrë nuk na la pas dore, por gjithmonë na përkrahu dhe vazhdon të na mbulojë, edhe atëherë kur bëjmë ndonjë hap të gabuar në rrugën


tonë të vështirë të pas përfundimit të luftërave tona çlirimtarë!

Faleminderit Ambasador James W. Pardew, për kontributin Tuaj dhënë luftës për liri, çlirim e të drejta të barabarta të popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut! Hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO, dhe roli progresiv e paqësor në rajon dhe më gjérë i Maqedonisë së Veriut, është një nga nderimet më të mëdha që i bëhen SHBA-së, NATO-s dhe Juve personalisht, shumë i dashur dhe i nderuar Ambasador James W. Pardew!

Gjithmonë, në shkuj e në mijëvjeqare, populli shqiptar në përgjithësi dhe populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut në veçanti, do të jetë mirënjojës ndaj SHBA-së dhe Juve personalisht!

Prishtinë, 3 Maj 2021!





SONTE PËRCAKTOHEN FINALISTET E 'PLAY-OFF'-it

PRISHTINË, 3 MAJ - Sot (e martë) zhvillohen ndeshjet e pesta në "play-off"-in e FIVE STAR Superligës së Kosovës në basketboll, ku do të vendoset se kush do të kualifikohet në finalen e madhe. Takimet në mes të Ponte Prizrenit dhe Pejës dhuruan emocione të mëdha, me basketboll të bukur e aksione atraktive, kurse të martën adrenalina do të rritet në maksimum në sfidën vendimtare mes këtyre dy skuadrave. Pejanët kishin fituar takimin e parë 92:100, kurse më pas prizrenasit fituan 112:111, në një përballje dramatike, derisa sfida e tretë përfundoi me fitoren e verdhezinje 108:85, ndërsa e fundit 62:88 në të mirë të prizrenasve. Rahoveci-Golden Eagle Ylli po pritet me interesim të madh. Derby regional ka qenë shumë interesant në vitet e fundit, kurse përballja e pestë do të vendosë se kush shkon në finale. Më vend për gabime nuk ka dhe kush gabon eliminohet. Takimin e parë e fituan rahovecasit 69:66, derisa të dytin therandasit 62:70 e, po ashtu, edhe takimin e tretë 77:68, kurse përballjen e fundit e fituan "Vreshtarët" 66:69.

Të martën takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Peja
20:15 Rahoveci - Golden Eagle Ylli



PESË VJET NGA ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË UEFA

Prishtinë, 3 maj - Me 28 vota për, 24 kundër dhe dy abstenime në kongresin e UEFA-s në Budapest, më 3 maj 2016, Kosova u pranua si anëtare me të drejtë të plota, duke u bërë kështu anëtarja e 55-të e kësaj organizate evropiane të futbollit. Kryetari i atëhershëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, i cili ishte i pranishëm në Kongresin e UEFA-s, anëtarësimin e Kosovës në UEFA e pati cilësuar si një arritje historike dhe një drejtësi të vonuar. "Një drejtësi e vonuar por, duke marrë parasysh bllokadat ligore që i janë paraqitur Kosovës ne arritëm të pranohemi, kjo është një arritje e jashtëzakonshme. Momentet brenda kuvendit të UEFA-as

ishin të vështira për shkak të kahut që i dhanë kuvendit disa shtete. Megjithatë, ne arritën të anëtarësohem i UEFA", pati thënë Vokri.

Kundër anëtarësimit u pozicionua Serbia. "Politika dhe futboli nuk duhet të ngatërohen në mënyrën më të shëmtuar. Ne do të kujdesemi për një protestë në rajon", kishte thënë para votimit Tomislav Karaxhiq, shef i Federatës i Futbollit të Serbisë. Anëtarësimi në UEFA u mundësoi ekipeve të Kosovës që të marrin pjesë në garat evropiane të futbollit. Po ashtu, kjo i hapi rrugë Kosovës që të anëtarësohet edhe në Federatën Botërore të Futbollit - FIFA, në Meksiko Siti, në kongresin e mbajtur më 12 dhe 13 maj 2016.



PSG-ja SYNON PËRMBYSJEN E CITYT

MANCHESTER, 3 MAJ - Paris Saint-Germain po synon përmbysjen e rezultatit në ndeshjen kthyese të gjysmëfinales së Ligës së Kampionëve kundër Manchester Cityt. Klubi francez e humbi ndeshjen e parë në "Parc des Princes", por tash është përgatitur maksimalisht që të shënojë fitore dhe të kualifikohet në finale. Selmuesi Neymar ka thënë se është i gatshëm që të vdesë në fushë vetëm që skuadra e tij të kualifikohet në finale. "Ndeshja e parë kundër Manchester Cityt ishte shumë e vështirë, por ne duhet të besojmë, pavarësisht se çfarë thonë statistikat dhe përqindja e mundësive tona për të fituar. Unë jam në vijën e frontit dhe do të jem luftëtar i parë që i futet betejës për ekipin. Do ta jap më të mirën nga vetja dhe do të bëj gjithçka për ta arritur finalen, edhe në qoftë se duhet të vdes në

fushë", ka thënë Neymar.

Manchester City, që është në rrugë të mirë të shpallet kampion edhe në Angli, është gati të mos lejojë befasi në ndeshjen kthyese dhe të kualifikohet në finalen e madhe. Trajneri Pep Guardiola ka thënë se PSG-ja është një skuadër e jashtëzakonshme, por që City e ka synim kualifikimin. Strategu spanjoll është i bindur se ka ardhur koha që skuadra e Manchester Cityt të kualifikohet në finale. "PSG është një skuadër e jashtëzakonshme, të gjithë e kanë të qartë. Ata kanë potencialin për ta përmbysur rezultatin por, në të njëjtën kohë, jam i vetëdijshëm se sa mirë mund të paraqitemi ne. Duhet të zgresim në fushë me të njëjtin shpirt gare që luajtëm në Francë. Do të tentojmë të kalojmë në finale. Ka ardhur koha t'ia dalim", ka thënë Guardiola.



10

FORMACIONET E MUNDSHME:

Manchester City: Ederson; Walker, Dias, Stones, Zinchenko; Rodri, Gundogan, Silva; Mahrez, De Bruyne, Foden.

Paris Saint-Germain: Navas; Florenzi, Marquinhos, Kimpembe, Bakker; Paredes, Herrera; Di Maria, Verratti, Neymar; Mbappe.

Conte: Titull fantastik, dalja nga Liga e Kampionëve ishte vendimtare

MILANO, 3 MAJ - Antonio Conte është arkitekti i rikthimit të zikaltërve te titulli kampion pas 11 vjetësh. Strategu italian është shfaqur shumë i lumburt pas këtij suksesi që vjen katër javë para fundit të kampionatit. "Ky është një nga sukseset e mia më

të rëndësishme në karrierë. Momenti më vendimtar ishte java kur dolëm nga Liga e Kampionëve, kur kishte kritika të ekzagjeruar. Nuk ishte e thjeshtë, sepse ishte një grup djemsh jo të mësuar për të qenë kompetitiv. Kemi qenë shumë

të zotë dhe të bashkuar, për të kaluar këto kritika të ekzagjeruar, për të qenë më të fortë. A do të qëndrojë tek Interi? Do të kem kohën e nevojshme për të bërë atë që bëra, tani dua ta shijojë titullin. Mungojnë edhe katër ndeshje,

kemi fituar kampionatin katër javë para fundit, kjo është fantastike. Juve-Inter? Do të shkojmë për të luajtur dhe kaq. Do të jetë kënaqësi që të kthehem në Juventus Stadium si kundërshtar", ka dekluar Conte.



Llapi përforcohet me një brazili

Podujevë, 3 maj - Finalisti i Kupës së Kosovës në futboll, Llapit, ka njoftuar se ka nënshkruar kontratë me sulmuesin brazili Alef Firmino Dos Anjos. Brazili i së fundmi ishte pjesë e NK Dubrava Zagreb, klub i cili bën gara në katgorinë e futbollit në Kroaci. 23-vjeçari, i cili luan si qendërsulmues, ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Llapin. "Skuadra e Llapit ka arritur t'i sigurojë shërbimet e sulmuesit të qendrës nga Sau Paulo i Brazilit, 23 vjeç, Alef Firmino Dos Anjos. Sulmuesi Alef Firmino Dos Anjos ishte bashkuar me skuadrën nga muaji prill i këtij viti dhe pas performancës së treguar ka bindur drejtuesit ta kenë pjesë të skuadrës për edicionin e ri garues", thuhet tutje në njoftimin e skuadrës së Llapit. "Ai së fundmi ishte pjesë e Ligës së Dytë të Kroacisë te skuadra e NK Dubrava ZG, kurse performancat më të mira i kishte sa ishte pjesë e skuadrës, NK Nasice, ku për 26



ndeshje kishte arritur shifrën e 20 golave dhe 8 assistimeve gjatë edicionit 2019/20. Gjatë vitit 2020 ai ishte shpallur sulmuesi më i mirë në Zagreb gjatë kohës sa ishte

pjesë e skuadrës NK Nasice. Ky transferim u bë i mundur me ndërmjetësim të menaxherit Arbenit Sinani", thuhet në njoftimin e klubit llapjan.

Lakersat zhgënjejnë sérish

LOS ANXHELOS, 3 MAJ - Los Angeles Lakersi vijon të zhgënjejë, pasi ka regjistruar humbjen e tretë radhazi në kampionat dhe kanë komplikuar totalisht arritjen e një vendin që të çon direkt në fazën e 1/8-ave të "play-off"-it. Kanë qenë kanadezët e Toronto Raptorsit ata që ia kanë dalë të largohen si triumfatorë nga "Staples Center", pasi fituan me shifrat 114-121 dhe tani e shohin veten gjithmonë e më pranë zonës "play-off". Kalifornianët e nisën mirë ndeshjen dhe mbyllën fraksionin e parë me 6 pikë avatash, por në pjesën e dytë bënë një paraqitje katastrofike, duke humbur me shifrat 21-40, disavantazh që nuk arritën të rikuperojnë deri në fund. Kamerunasi Pascal Siakam dhe amerikanë Kyle Lowry shkëlqyen për kanadezët e Torontos, pasi të dy së bashku realizuan 76 pikë, 15 rikuperime dhe 15 asistime, ndërsa te Lakersat mbetën në hije si Anthony Davies, ashtu edhe LeBron Jamesi. Vjon të bëjë mirë Phoenix Suns, që nuk dorëzohet në garën për kryesimin në Konferencën e Perëndimit, pasi ia



doli të triumfojë me rezultatin e ngushtë 120-123 në transfertën ndaj Oklahoma City Thunderit, duke regjistruar edhe suksesin e katërt radhazi. Në "Energy Arena" të Oklahomës vendasit u treguan superiorë në fraksionin e parë dhe të katërt, ndërsa pjesa e dytë dhe e tretë foli për Sunsin, që falë një forme mjaft të mirë të Bookerit, ia doli të triumfojë. Një nga sfidat më interesante të mbrëmjes ishte pa dyshim ajo në mes të San Antonio Spursit dhe Philadelphia 76ers, e cila u fitua nga miqtë me rezultatin 111-113 vetëm pas luajtjes së kohës shtesë. Miqtë e nisën mirë takimin dhe morën një avatash

prej 10 pikësh në fund të fraksionit të parë, por më pas loja e tyre erdhë duke u zbehur dhe koha e rregullt përfundoi në barazim 107-107. Në shtesë ishin 76ers që ia dolën ta marrin fitoren falë edhe një forme mjaft të mirë të kamerunatis Embiid, që mbylli ndeshjen me 34 pikë, 12 rikuperime dhe një asistim. Në sfidat e tjera, Boston Celticsi u dorëzua në shtëpi përbollë Portland Trail Blazersit që triumfoi me rezultatin 119-129, Sacramento Kings imposhti Dallas Mavericksit në transfertë me shifrat 99-111, ndërsa New York Knicksit 97-122 ndaj Houston Rocketsit.

Barça, gati 60 milionë euro dhe tre futbollistë për Neymarin

Barcelona e ka seriozisht për Neymarin. Mediat katalanase bëjnë me dije se drejtuesit e klubit kanë nisur kontaktet me PSG-në për t'i treguar interesimin rreth sulmuesit

brazili. Barcelona është e gatshme që të ofrojë 60 milionë euro dhe të përfshirë disa futbollistë të tjerë në këtë operacion. Neymar nuk ka rinnovuar ende kontratën me PSG-në

dhe dëshira e tij është që të bashkohet me Lionel Mesin. Diçka të tillë e ka bërë më të besueshme drejtori sportiv Leonardo. Brazili i thotë se asgjë nuk është e sigurt dhe

do t'i shohim gjërat me qetësi. "Duhet të shohim gjithçka me qetësi. Unë kam ardhur këtu për ta parë ndeshjen e femrave dhe jo për të folur për këto tema", ka thënë Leonardo.

SHKURT

Lëndohet Kumbulla

Marash Kumbulla, i cili u rikthye në fushën e blertë pas një periudhe njëmuore, dëmtohet sërisht në sfidën ndaj Sampdorias, ku Roma pësoi humbje me rezultatin 2-0. Kumbulla gjatë një dyluftimi me lojtarin kundërshtar në minutën e 64-t ndjeu dhimbje në shpinë dhe u zëvendësua menjëherë duke i bërë vendin Ibanjezit. Një lajm i keq ky për Romën dhe kombëtaren shqiptare, nga ku mbrojtësi po vuan dëmtime të njëpasnjëshme dhe nuk dihet ende arsyja e dëmtimeve kaq të shpeshta.

IOC: 60 % e sportistëve të vaksinuar deri në 'Tokio 2020'


Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) beson se deri në momentin që do të nisin Lojërat Olimpike "Tokio 2020" do të jenë vaksinuar 60 % e sportistëve pjesëmarrës. Bëhet fjalë për sportistët që do të mbërrijnë në Japoni deri më 32 korrik, kur nis Olimpiada. Mjaft vende, nga Amerika deri në Korenë e Jugut, kanë nisur me kohë ta jepin vaksinën për sportistët që do të shkojnë në këtë ngjarje olimpike. IOC mendon se më shumë se gjysma e 200 vendeve pjesëmarrëse do të vaksinohen deri në korrik. Pavarësisht prej kësaj, të gjithë sportistët do të zbatojnë masa të rrepta kundër Covidit gjatë Olimpiadës, duke mos u lejuar të lënë Fshatin Olimpik. Në rast se në Fshatin Olimpik do të ketë një përhapje të madhe të virusit, atëherë Olimpiada mund të pezullohet.

Vdekja e Astorit, dënohet kardiologu që e kishte kontrolluar

Kardiologu Giorgio Galanti është dënuar me një vit burg për vdekjen e futbollistik të itali Davide Astori në vitin 2018. Astori vdiq si pasojë e një ataku kardiak, por rezulton se vdekja e tij mund të ishte shmangur. Pika e rëndësishme kardiologu i cili akuzohet sot për vrasje, nuk ka vënë më pah disa anomali të Astorit gjatë testit të stresit. Në fakt, për vdekjen e Astorit janë nën hetim dy mjekë, teksha humbja e tij e parakohshme tre vjet më parë tronditi futbollin itali.

Valencia shkarkon trajnerin Gracia

Humbja ndaj Barcelonës duket se ka qenë e destinuar të jetë e fundit për Javi Gracia si trajner i Valencias. Ndesha ndaj Barçës ishte ndeshja e gjashtë pa fitore për Valencian, duke humbter terren në renditje dhe mos siguruar ende qëndrimin në La Liga për sezoni e ardhshëm. Forma e dobët e ekipit ka sjellë një mbledhje urgjente të drejtuesve të dielën në mëngjes, ku është vendosur shkarkimi i Gracia pas 8 muajsh nga emërimi i tij. "Valencia njofton shkarkimin e Javi Gracia si trajner i ekipit të parë. Klubi dëshiron t'ju falënderojë publikisht për punën dhe përkushtimin tuaj gjatë këtyre muajve në krye dhe ju uron sukseset më të mira për të ardhmen. Salvador Gonzalez 'Voro' do ta drejtojë ekipin e parë në baza provizore", thuhet në njoftimin e Valencias.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

[facebook](#) 

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 [Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi](#)

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "AJOU SYSTEMS" SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811486720 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AJOU SYSTEMS" D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811486720, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "AJOU SYSTEMS" L.L.C, has come to the decision to quit its nr. 811486720, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardhmërie Berisha shpal当地海龟保护中心 t të humbura katër dëfesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Profesionale "Ali Sokoli" Prishtinë.
- Jap banesë me qira afér 60 m², kat i III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, koridor banjo ballkon . Banesa eshtë e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira pér afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet pér një qift ose pér dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë pér përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira pér student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa eshtë 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kat i dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa eshtë ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përbal "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kat i dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ROYAL CROWN
RC cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA Since 1905 0.5L

A blue RC Cola can and a dark plastic bottle of RC Cola are displayed on a wooden surface in the bottom right corner of the advertisement.